



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:081904

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06334950

K.DH.SH.II.nr.1072/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Seti Commerc” ShPK me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liridon Bullakaj, avokat, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.305/22 të datës 22.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Seti Commerc” Sh.p.k me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës, e datës 04.04.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.305/22 të datës 22.03.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë—Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitiv ka vendosur: I. Refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Seti Commerc” me nr. të biznesit 810633116, me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës, me çka ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Suharekës me numër ref: 01-N-332-23536 të datës 26.06.2020, si e pa bazuar. Në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkelejve qenësor të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të paditësit të bie aktgjykim me të cilin miratohet ankesa e paditësit “Seti Commerc” Shpk me NRB: 810633116 me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës si e bazuar, të prishet aktgjykimin i Gjykatës Komerciale në Prishtinë KA.nr.305/22 të datës 22.03.2024 si i pa bazë ligjore, ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194,i Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK),ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur, me vendimin me numër ref: 01-N-332-23536 të datës 26.06.2020 nën pikën I. të dispozitivit të vendimit,Refuzohet ankesa 01-nr-332-23536 e datës 16.06.2020 e ankuesit “Seti Commerc” Shpk & “Drini Company” Shpk të cilin e përfaqëson Nisret Bajraktari me të cilin ka kundërshtuar njoftimin 01-nr-104-22338 të datës 11.06.2020 si të pa bazuar. Nën pikën II. mbetet në fuqi njoftimi 01-nr-104-22338 i datës 11.06.2020 i Komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. Nën pikën III. ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi, me padi inicicion konflikt administrativ në procedurë gjyqësore. Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, në këtë çështje juridike administrative të paditësit, mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 27.07.2023, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në prani të përfaqësuesit të paditurës dhe pas administrimit të provave, bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin, e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara gjykata vlerësoj këtë gjendje faktike: sipas shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 kriteret e kërkuara janë: Deklarata vjetore tatimore nga ATK-ja për 2(dy) vitet e fundit, Vlera e investimeve konform deklaratave vjetore për dy vitet e fundit - do të vlerësohet për objekt 15% tw pikëve, ndërsa për pajisje 5% tw pikëve, Çmimi për metër katror të parcelës, minimumi 0.05 cent/ m2 në vit, numri i të punësuarve, specifiko pozitat e deklaruara të punëtoreve - numri i punëtoreve duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve, lloji i veprimtarisë adekuate, personat fizik dhe juridik që nuk posedojnë pronë në shfrytëzim në ZI- Shiroke vlerësohet me 5% të pikëve, plani dinamik - jo më shume se dy vite...15% të pikëve, projekti ideor konform Planit Rregullues të Hollësishëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planit investiv me 10% të pikëve. Gjykata vlerëson se sipas shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 janë kërkuar Plani dinamik - jo më shume se dy vite...15% te pikëve dhe Projekti ideor konform Planit Rregullues të Hollësishëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planit investiv me 10% të pikëve, ndërsa paditësi ka dorëzuar Plani dinamik ku janë përcaktuar aktivitetet punuese dhe afati për kryerje të punimeve për tre muaj, nga dosja origjinale konstatohet se paditësi ka dorëzuar Planin Ideor, dhe ka dorëzuar Paramasë dhe Paralogaria paditësi i ka përcaktuar punët përgatitore, punët e betonit, punët e muratimit dhe suvatimit, punët e konstruksionit metalik, punët e dyshemesë, punët e partneritetit dhe punëve të ndryshme të detajuara njësia, sasia, çmimi, shuma totale në vlerë prej 1,721,037.90 €. Gjykata vlerëson se Paramasa dhe paralogaria e dorëzuar nga paditësi nuk përmban të gjitha elementet që do të duhej të përmbajnë, përveç objektivave-përcaktimit të punëve dhe shumës së investimit nuk përmban, planin financiar, investimet kapitale dhe shpenzimet operative, rreziqet e investimit, etj. Gjykata vlerëson se vendimin i kundërshtuar me nr. Ref. 01-Nr-332-23536 i datës, 26.06.2020 i nxjerrë nga Komisioni i Ankesave të Komunës së Suharekës, me të cilin e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, me arsyetim se vendimi i organit administrativ të shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkakun se paditësi nuk e ka prezantuar planin investiv, e që ka qenë kërkesë specifike e shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 ku theksohet se kriteret e kërkuara përveç tjerash janë Projekti ideor konform Planit Rregullues

të Hollësishëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planit investiv më i vlerësuar me 10% të pikëve. Po ashtu gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar është në përputhje me nenin Neni 47 të LPPA-së, sa i përket strukturës dhe i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar si dhe arsyetimin konform nenit 48 të LPPA-së. Prandaj duke qenë se nga provat e administruara nuk u vërtetuan pretendimet e paditësit, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

Dhoma e Shkallës Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative, të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA-së lidhur me nenin 194 të LPK-së, dhe as me shkelje sipas pretendimeve në ankesë, sepse procedura në Dhomën e Shkallës së Parë është zhvilluar ashtu siç parashihet me ligj, dhe ligjshmëria e aktit administrativ përfundimtar–vendimit të paditurës, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, si dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së është vlerësuar drejtë, bazuar në pretendimet në padi, përgjigjes në padi si dhe të provave dhe dëshmive të administruara në seancë gjyqësore.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vendosur drejtë, duke u bazuar në nenin 9 të LKA-së i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*. Në aplikacionin e datës 26.02.2020 paditësi kishte bashkangjitur: dokumentacionin i regjistrimit të biznesit, deklaratat e tatimit në prove, vërtetimin tatimor, deklarimi i të ardhurave të korporatave, dokumentacioni i dorëzuar për NNTSH “Drini Company” SH.P.K, Marrëveshje e grupit të OE “Seti Commerc” dhe NNTSH “Drini Company” Shpk, Plani dinamik, lista e numrit të punësuarve, Paramasa dhe parallogaria. Kriteret e kërkuara janë plotësuar nga raporti i Komisionit për vlerësimin e ofertave të datës 20.05.2020, me të cilin paditësi është eliminuar për shkak të mungesës së planit rregullativ. Kundër vendimit për eliminim paditësi ka parashtruar ankesë me datë 01.06.2020, Komisioni i Ankesave i Komunës së Suharekës me Vendimin Ref. 01-Nr-615-18547/2020 e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ka

kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivlerësim të ofertave që të sqarohet nëse plani investim duhej të paraqitej si dokument i veçante apo mund të paraqitej se bashku me planin ideor. Gjykata vlerëson se Paramasa dhe paralogaria e dorëzuar nga paditësi nuk përmban të gjitha elementet që plani investiv do të duhej të përmbajnë, përveç objektivave-përcaktimit të punëve dhe shumës së investimit nuk përmban, planin financiar, investimet kapitale dhe shpenzimet operative, rreziqet e investimit, etj. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin pasi që nga provat e administruara ka rezultuar se paditësi nuk ka plotësuar kriterin sipas konkursit të hapur nga Komuna e Suharekës duke mos i bashkangjitur dokumentacioneve për aplikim planin ideor konform planit rregullues të hollësishëm Zona Industriale Shirokë si dhe planin investiv, andaj me të drejtë e paditura ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të paditësit. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Seti Commerc” Shpk, me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Suharekës me numër ref: 01-N-332-23536 të datës 26.06.2020.

Gjykata e Dhomës së Dytë ka vlerësuar pretendimet ankimore lidhur me at se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh parashtrësën lidhur me shtyrjen e seancës por e refuzoj si të pa bazuar për shkak se paditësi e as i autorizuari i paditësi me rastin e propozimit për shtyrje të seancës së datë 06.03.2021 nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do të mund që gjykata e shkallës së parë ta vlerëson propozimin për shtyrje të seancës, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar shtyrjen e seancë në mungesë të provave të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë.

Në raport me pretendimet ankimore të paditësit për shkelje të dispozitave të procedurës konsistojnë në faktin se arsyetimi i aktgjykimit nuk është i qartë është i pa kuptueshëm është në kundërshtim me arsyetimin dhe si i tillë nuk mund të qëndroj i njëjti aktgjykim është kundërthënës me vetveten dhe në të nuk janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare, ndërsa arsyet e parashtruara në aktgjykimin e atakuar janë kontradiktore me vetveten dhe përmbajtjen e provave të cilat po të administroheshin drejtë gjykata do të nxirrte një konkludim tjetër, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket e pretendimeve se gjykata gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se nuk ka administruar drejtë të gjitha provat e parashtruara nga paditësi nuk ka marrë për bazë faktin se paditësi me kohë ka ndërmarr të gjitha veprimet juridike të mundshme (vazhdimisht është ankuar) e gjithë kjo pasi që sipas konkursit të hapur me datë 01/2020 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri 99 vite të pronës së paluajtshme komunale, gjegjësisht parcelës 2785/25 sip 8000m2 sipas planit rregullativ “depo ndërtimore”. Paditësi me datën 26.02.2020 ka paraqitur aplikacionin e tij në konkursin e shpallur dhe ka bashkangjitur çdo dokument të kërkuar në konkurs. Këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë e refuzoi si të pa bazuar për arsye se në shkresat e lëndës gjenden, dokumentacioni i regjistrimit të biznesit, deklaratat e tatimit në prove, vërtetim tatimor, deklaram i të ardhurave të korporatave, dokumentacioni i dorëzuar për NNTSH “Drini Company” Shpk, Marrëveshje e grupit të OE “Seti Commerce” dhe NNTSH “Drini Company” Shpk, Plani dinamik , lista e numrit të punësuarve, Paramasa dhe parallogaria, dokumente këto të bashkangjitura edhe me rastin e aplikimit nga paditësi në konkursin e shpallur, mirëpo nuk është paraqitur nga paditësi plani investiv si kriter i kërkuar dhe i cili është i vlerësuar me 10%, ndërsa kolegji lidhur me paramasën dhe parallogarinë e dorëzuar nga paditësi kolegji njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se nuk përmbajnë të gjitha elementet që do të duhej të përmbaj plani investiv. Andaj Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1072/24, me datë 21.10.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymer